

Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Meteorologjisë të derdhë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Tiranë, kontributin e sigurimeve shoqërore për llogari të ish-punonjësit Durim Grabova, si punëdhënës në masën 16.7% të pagës bruto për periudhën 26.09.2013, deri më datë 20.01.2015, në mbështetje kjo të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, neni 9 në shumën 15932 lekë për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin për pagën në shumën 9540 lekë.

*Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.
Ky vendim është i formës së prerë.”.*

Konstatohet, se ky vendim është i formës së prerë nga data e shpalljes, referuar dispozitivit të tij:

Me rastin e pranimin për shqyrtim të kësaj çështjeje, Institucioni Avokatit të Popullit ka kërkuar DPM-së, informacion dhe shpjegime rreth çështjes si dhe prezantimin e shkaqeve të cilat do të mund të justifikonin mosekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.232, datë 01.02.2021, të dhënë prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në përgjigje të kërkesës, me Tuajat nr.880/1 Prot, datë 02.05.2023, dhe nr.938/1 Prot, datë 08.05.2023, justifikoni mospërmbushjen e detyrimit me deklarime/pretendime të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me rastin e dhënies së vendimit nr.232, datë 01.02.2021. Po kështu, në mënyrë kronologjike prezantoni mosmarrëveshjet e zgjidhura në rrugë gjyqësore me ankuesin, përpara dhënies së vendimit nr.232, datë 01.02.2021 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ndodhur në kushtet e mospërmbushjes vullnetarisht të detyrimeve të vendosura, gjyqfituesi/ankuesi Durim Grabova, ka kërkuar më datë 22.2.2019, pranë Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Privat, Shoqëria e Përmbarrimit Privat, “Elite Bailiff’s Office” shpk., vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv të lartpërmendur, për të mundësuar materializimin e së drejtave të fituara në rrugë gjyqësore.

Me rastin e pranimin të kërkesës për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, përmbarruesi gjyqësor privat i çështjes, z.Desian Brahimllari, ka lajmëruar me shkresën nr.559 Prot, datë 04.03.2021, DPM-në, për detyrimet e vendosura sipas titullit të mësipërm ekzekutiv, duke caktuar me këtë rast dhe afatin ligjor për përmbushjen e detyrimeve në mënyrë vullnetare.

Në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve në afatin ligjor për zbatimin/dorëzimin vullnetar apo prezantimit të shkaqeve të cilat do të mund të justifikonin mosekzekutimin e detyrimeve të vendosura, përmbarruesi gjyqësor i çështjes, ka filluar kryerjen e veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor në fjalë, në ngarkim të DPM-së, duke vendosur me shkresën nr.704 Prot, datë 08.04.2021, masën e sekuestrës mbi llogarinë e saj pranë Degës së Thesarit Tiranë. Rivendosur kjo masë dhe me shkresën nr.1094 Prot, datë 15.05.2023.

Dega e Thesarit Tiranë, me rastin e marrjes dijeni të sekuestrës së vendosur nga përmbarruesi gjyqësor i çështjes mbi llogarinë e DPM-së, me shkresën nr.2618/3 Prot, datë 19.04.2021, ka njoftuar Sektorin e Shpenzimeve në varësi të DPM-së për bllokimin e fondeve buxhetore në artikullin 602, në kushtet e mosveprimit, nxjerrjes së urdhërshpenzimit, për shlyerjen e detyrimit në të holla, si dhe njoftuar me shkresën nr.2618/1 Prot, datë 15.04.2021, për veprimet në zbatim të Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit”.

Ndodhur në kushtet e mosveprimit për dorëzimin e detyrimit në të holla, konstatohet se, gjyqfituesi/ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë për urdhërimin e kryerjes së veprimeve të posaçme për përfundimin e ekzekutimit të të gjitha pikave të vendimit nr.232, datë 01.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur me vendimin nr.53, datë 26.10.2021:

“Pranimin e kërkesës, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të posaçme për përfundimin e ekzekutimit të të gjitha pikave të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr.232, datë 01.02.2021, nga ana e debitorit, Drejtoria e Përgjithshme e Meterologjisë. brenda një afati 1 muajor.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Ky vendim është i formës së prerë dhe me ekzekutim të drejtpërdrejtë”.

Edhe pse, Gjykata ka urdhëruar kryerjen e veprimeve të posaçme për përfundimin e ekzekutimit të të gjitha pikave të vendimit nr.232, datë 01.02.2021, brenda një muaji nga data e dhënies së tij, DPM-ja, përsëri nuk ka kryer dhe nuk kryen veprime për dorëzimin e detyrimeve në të holla në favor të palës kreditore.

Në kushtet e shkeljes së afatit të urdhëruar sipas vendimit gjyqësor nr.53, datë 26.10.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe atij të arsyeshëm të parashikuar në nenin 399/1, pika 1, të K.Pr.C., për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas vendimit gjyqësor administrativ nr.232, datë 01.02.2021, pala kreditore, ka ushtruar të drejtën e kërimit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm si dhe përshpejtimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit nr.232, datë 01.02.2021, të dhënë nga ana e saj.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.38, datë 07.09.2022, ka vendosur për:

“Pranimin e kërkesës duke konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm 1 vjeçar në kuadër të procedurave për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr.232, datë 01.02.2021 nga ana e debitorit Drejtoria e Përgjithshme e Meterologjisë.

Paditësit i lind e drejta që konform nenit 399/4, paragrafi i dytë, të ushtrojë kërkesë-padi për shpërblimin e dëmit si rezultat i vonesës në ekzekutim.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të personit të tretë.

Ky vendim është i formës së prerë”.

Bazuar në këtë vendimmarrje, ankuesi ka kryer ngritjen e padisë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministrisë së Drejtësisë për shpërblimin e dëmit për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor në fjalë në afatin e urdhëruar apo afatin e arsyeshëm.

Përmbushja e detyrimit në të holla ndaj gjyqëfituesit nuk është kryer dhe nuk kryhet prej DPM-së, edhe pse kjo Drejtori në asnjë rast nuk ka pretenduar mosdisponim vlerash në të holla për shyerjen e detyrimeve financiare në favor të kreditorit Durim Grabova.

Shkaktimi i dëmit ekonomik, si rrjedhojë e zgjidhjes së marrdhënieve të punës në mënyrë të padrejtë e të paligjshme me gjyqfituesin, duhet të jetë pjesë e veprimtarisë së

Drejtorisë tuaj, me rastin e ekzekutimit të detyrimit në të holla, konform përcaktimeve të kryera në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012, të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, (neni 62), apo në Udhëzimin nr.1 datë 13.06.1997, të Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit, përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryejë auditimin e gjithë procesit, i cili ka sjellë dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile, kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura, ka sjellë dhe do të sjelli cenim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë me rastin e mosrespektimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sjellim në vëmendje se objektivi i Qeverisë ka qenë dhe është, moslejimi i borxheve të reja, i shprehur ky në VKM-në nr.50, datë 05.02.2014, “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”.

Në cilësinë e palës debitore, DPM-ja, në vlerësimin e Institucionit tonë, nuk ka kryer rregullisht veprimet për dorëzimin e detyrimit në të holla sikurse parashikuar në nenin 589 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet, se:

“Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare ose në kredi që kanë te të tretët. Nuk lejohet ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e luajtshme e të paluajtshme të institucionit buxhetor.

Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare e as kredi te të tretët, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm e kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga buxheti i shtetit”.

Në korespondencën e zhvilluar me Institucionin e Avokatit të Popullit, Drejtoria juaj, nuk ka pretenduar mungesën e gjendjes në të holla për shlyerjen e detyrimit, por pretendimin se vendimi gjyqësor nr.232, datë 01.02.2021, nuk ka marrë formë të prerë, paqartësi lidhur me tatimin mbi të ardhurat sikurse vendosur në dispozitivin e vendimit.

Në cilësinë e palës debitore, DPM-ja ka pasur dhe ka të drejtën e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore apo ngritjes së padisë për pavlefshëmri të titullit ekzekutiv, vendimit gjyqësor nr.232, datë 01.02.2021, për fakte të ngjara pas dhënies së vendimit. Konstatohet se, DPM-ja ka paguar tatimin mbi të ardhurat, në zbatim të vendimit gjyqësor nr.2335, datë 25.05.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas Urdhër shpenzimit nr.319, datë 17.11.2017. Për këtë vlerë të paguar, DPM-ja, shprehet se është ngarkuar përsëri sipas vendimit gjyqësor nr.232, datë 01.02.2021, ta ripagujë këtë vlerë në favor të palës gjyqfituese. Për zgjidhjen e këtij pretendimi, DPM-ja, ka pasur mundësinë e ushtrimit të mjeteve ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese në kushtet e konsiderimit të dhënies së vendimit nr.2335, datë 25.05.2017, prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, jo në respektim të ligjit.

Ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, kundër vendimit gjyqësor nr.232, datë 01.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk mund të shërbej si shkak për mosekzekutimin e vendimit në fjalë, referuar përcaktimit të bërë në dispozitivin e tij, se:

“...Ky vendim është i formës së prerë.”.

Në kushtet e kryerjes së veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, çështja e pagimit me preferim (neni 605 i Kodit Civil) kryhet nga ky Shërbim për titujt ekzekutiv që ai ka në proces ekzekutimi.

DPM-ja, respekton kryerjen pagesës me preferim, referuar parashikimit në nenin 605 të Kodit Civil, për shuma në të holla mbi të cilat nuk është vendosur masa e sekuestrës dhe për çështje/tituj ekzekutiv, të cilët nuk janë në proces ekzekutimi pranë Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor.

Personi i tretë në këtë proces, Dega e Thesarit Tiranë, me marrjen e lajmërimit për vendosjen e masës së sekuestrës mbi shuma të caktuara në të holla, në llogarinë (artikullin 602) në buxhet të DPM-së, i ndalohej në kuptim dhe zbatim të dispozitës ligjore, neni 581 i K.Pr.C., të dorëzojë debitorit kredinë e sekuestruar.

Pala e tretë, Dega e Thesarit është subjekti që në zbatim të parashikimit të nenit 583/b të K.Pr.C i përgjigjet përmbartuesit gjyqësor, midis të tjerave, nëse mbi kredinë e sekuestruar kanë pretendime dhe persona të tjerë. Dega e Thesarit Tiranë, në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 584 të K.Pr.C. si dhe Udhëzimit nr.01, datë 04.06.2014, të Këshillit të Ministrave, detyrohet t'ia dorëzojë shumën e sekuestruar përmbartuesit gjyqësor të çështjes. Në këtë procedurë, Dega e Thesarit Tiranë, duhet të administrojë dhe urdhër-shpenzimin e palës debitore për kalimin e detyrimit në zbatim të vendimit gjyqësor në fjalë, i cili pa shkak sikurse përshkruar më sipër nuk është nxjerrë ende prej DPM-së.

Ka qenë dhe është detyrim për DPM-në kryerja e procedurave për nxjerrjen e urdhër-shpenzimit për dorëzimin e shumave, konform parashikimeve të kryera në K.Pr.C. si dhe Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, të Këshillit të Ministrave. Mosdorëzimi i shumës në të holla të sekuestruar prej përmbartuesit gjyqësor të çështjes, edhe pse gjendja në të holla ka ekzistuar dhe ekziston e mjaftueshme për shlyerjen e detyrimit, përbën shkak për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 66 të ligjit nr.49/2012, *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, të nenit 68 të ligjit në fjalë, të vendos gjobë ndaj titullarit të organit publik debitor, të kërkojë marrjen e masave disiplinore dhe, kur është rasti, të paraqesë kallëzim penal ndaj personave përgjegjës. Kjo procedurë e parashikuar në ligj kryhet nga Gjykata, me rastin e marrjes së njoftimit zyrtar prej përmbartuesit gjyqësor të çështjes për situatën në të cilën ndodhet procesi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Në kushtet e kalimit të një afati prej afro 2.5 vjet nga vendosja e detyrimeve, është e pajustificueshme mospërmblidhja e tyre deri më sot, kjo dhe për faktin, se moszekzekutimi i detyrimit në të holla ka sjell për çdo ditë vonesë, pasoja financiare për buxhetin e shtetit dhe taksapaguesin shqiptar.

Moskryerja në mënyrë të rregullt e procedurës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.232, datë 01.02.2021, të dhënë prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vlerësohet jo në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse parashikuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Po kështu, qëndrimin e derisotëm nuk e gjykojmë në përmbushje të parashikimit të kryer në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin sanksionohet, se:

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”,

apo nenin 451/a të K.Pr.C, se:

“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...”

dhe as me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, sikurse parashikuar në K.Pr.A. dhe të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të këtij Kodi.

Asnjë argument i përdorur nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore.

Ka qënë dhe është detyrim për DPM-në, marrja e masave për përmbushjen e detyrimeve, sikurse përcaktuar në dispozitivin e titullit ekzekutiv të sipërcituar, dhe sikurse kërkuar nga ankuesi pranë Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor Privat. Në papajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, të parashikuar në K.Pr.A., nuk është bërë dhe nuk bëhet e mundur, ekzekutimi i detyrimeve, megjithëse Shërbimi i Përmbaramit Gjyqësor Privat ka lajmëruar për këto detyrime të vendosura si dhe ka caktuar afatin ligjor për dorëzimin vullantar të tyre.

Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e saj të vazhdueshme ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar në rrugë gjyqësore, pala debitore që ju përfaqësoni duhet të marrë pjesë aktivisht në ekzekutimin e detyrimeve.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare në vendimmarrjet e saj ka pranuar se: “... parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”.

Më tej, “...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.

Në këto kushte, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”,

si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se:

“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për përmbushjen sa më parë të detyrimeve të vendosura sipas vendimit nr.232, datë 01.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në favor të kreditorit/gjyqfituesit Durim Grabova

Auditimin e procesit për nxjerrjen e subjektit përgjegjës me rastin e kryerjes së veprimtarisë për pagimin e dëmit të ardhur sipas vendimit gjyqësor nr.232, datë 01.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në favor të kreditorit/gjyqfituesit Durim Grabova.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet mundësisht brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Në mungesë dhe me urdhër

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI

Konc dhe Dak
A.Gjoleka
Datë 02.08.2023